



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 351/02-15724/22 dt. 24.01.2022, e aplikuesit/pronarit Milot Osmani me inv. "Sovereign KS" sh.p.k, me seli në rr. Agim Ramadani në Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811275701, me pronar Arbër Hadri nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për lejimin e ndërtimit të tri (3) ndërtesave individuale banimore / shtëpi familjare – shtëpi në varg, me etazhitet B+S+P+Ph, në lagjen Sofalia, Prishtinë, në kuadër të bllokut urban "D-01", të tërësisë urbane "D", të Planit Rregullues të Hollësishtëm "Sofalia 2016-2024", gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1213-14; ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 24.06.2022 deri më 28.06.2022, në

E-mail adresat: [urbanizmi@rks-gov.net](mailto:urbanizmi@rks-gov.net); [marigona.gashi@rks-gov.net](mailto:marigona.gashi@rks-gov.net);

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tri (3) shtëpi individuale banimore / shtëpive familjare, me etazhitet B+S+P+Ph
b. Vija rregulluese	Kufiri i parcelës kadastrale / Rruga ekzistuese 5 m'
c. Vija ndërtimore	5 m' Kthina primare min 0.5 H Kthina sekondare min 0.2 H Më marrëveshje me fqin, deri në bashkim të plotë
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	5 m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	AM - Kthina primare min 0.5 H AD - Kthina sekondare min 0.2 H Më marrëveshje me fqin, deri në bashkim të plotë.
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP = 24.85 % 30 % e lejuar sipas PRR-së
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISHGJ 50 % e lejuar sipas PRR-së
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISPN = 73.27 % 80 % e lejuar sipas PRR-së
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISPN = 34.46 % 50 % e lejuar sipas PRR-së
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	1
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të VEPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda 5 ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet duhet të përshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:



Faqe 1 prej 1